



2015

RAPORT- TM₃ -2015



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A


Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME	5
II. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	6
2.1 Aktivitetet – Korrik - Shtator 2015	6
2.2 Prodhimi i ujit m ³	8
2.3 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	9
2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim	9
2.5 Servisimi I ujëmatësave	11
2.6 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	13
2.7 Raport per trajtimin e ujërave te zeza	14
2.8 Raport i Aktiviteteve te Njesive	14
III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	18
3.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	18
3.2 Aktivitetet e shërbimit te kontrolles	19
3.3 Pengesat ne realizimin e objektivave	20
3.4 Masat e realizuara	20
3.4 Planet për të ardhmen	20
3.5 Raport I mediave	21
IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	25
4.1.1 Aktivitetet – Korrik - Shtator 2015	25
4.1.2 Personeli	26
4.1.3 Raport I puneve te kryera nga gjykatat	27
V. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR	30
5.1 Aktivitetet – Korrik - Shtator 2015	30
5.2 Shpenzimet – Korrik - Shtator 2015	30

VI.	RAPORT I AUDITORIT TE MBREND SHEM	34
<hr/>		
VII.	RAPORT I PERFORMANCAVE OPERATVE DHE FINANCIARE TM1/TM2 -2015	35
<hr/>		
	ORGANOGRAMI	40
<hr/>		
<hr/>		
<hr/>		

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



FURNIZIMI

Furnizimi me uje te pijes ne nivel regjional ka qene i rregullt, nepër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë. Kompania është angazhuar dhe ka arritur që në TM-3, të vitit 2015 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku edhe kemi reduktime (Kryesisht te lagja Dardanisë, pjesa e Bazhdarhanës dhe në rrugën e Janinës). Në njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme me furnizim më ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e njesive operuese kemi patur furnizim të rregullët me ujë të pijes.

UJI I PRODHUAR

Për TM-3, të vitit 2015 në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **5,010,759.00 m³**, krahasuar nga TM paraprak kemi një rritje të prodhimit të ujit të pijes prej **728,169.00 m³**. Jane duke vazhduar aktivitetet për të mbajtur gjendjen stabile të furnizimit me ujë.

FATURIMI

Në periudhën e TM3 - 2015 janë faturuar 2.106.652 m³, apo 16.13% më shumë se në TM2-2015
Faturimi në Euro në TM3- 2015 ka qenë 1.145.251,89 €, në krahasim me TM2 -2015 ka pas një rritje prej 12.65%

INKASIMI

Në periudhën e TM3 -2015 janë inkasuar 854.456,66€ , apo 15.28% më shumë se në periudhën TM2 -2015.
Përqindja e inkasimit ishte 72.98% ose 1.26% më e lartë se në periudhën TM2 - 2015

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se.

Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektoret e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e defekteve sa më shpejtë.

Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogelimin e UPF-së dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Raportet tregojne që UPF në nivel regjional për TM-3, të vitit 2015 është **57,96 ose 0.27%** me rritje të UPF nga TM-2.

Faturimi në nivel regjional është prej **2,106,649.00m³** me një rritje të faturimit prej **294,533.00 m³** krahasuar nga tremujori paraprak.

SHPENZIMET

Shpenzimet në periudhën e TM3- 2015 arrinë në 766.840,00 € apo 9.70% më të larta se në periudhën TM2 -2015.

MBULIMI OPERATIV

Si rezultat i rritjes së inkasimit prej 113.236.29 €, edhe pse kishte rritje të shpenzimeve, për periudhën TM3- 2015 kompania ka arritur të kishte mbulim operativ pozitiv prej 1.11 (+ 87.616.66 €)

II. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

2.1 Aktivitetet - Korrik- Shtator – 2015

- *Takim ne DSHP-Prizren-me Pasawante dhe KWE per mundesine e fillimit te punimeve per shkak te komunikacionit
- *Takim ne MMPH-Per dergimin e verjetjes se PASSAVANTE ne lidhje me pagesen e avancit per Fazen I.
- *Dergimi i anekses se Passavante ne MMPH permes emailit.
- *Takim me Pune kryesin dhe konsulencen, per mundesine e fillimit te punimeve me daten e percaktuar nga Ministria e Infrastruktures.
- *Takim ne MMPH-Dergimi i njoftimit te Passavante per mundesine e nderprerjes se kontrates per shkak te voneses se avansit.
- *Takim ne MZHE me Ramadan Sejdiun ne lidhje me projektet e vitit 2015.
- *Takim me Udhheheqesin e Njesise per Bashkpunim Civil-Ushtarak ne kuader te KFORIT, ku teme diskutimi ishte njohurite rreth Furnizimit me uje te pijes dhe ecuria e projektit te ujerave te zaza edhe ne aspektin e planit dinamik per shkak te levizjes se KFORIT me automjetet e veta, ku dhe duhet bere ftesa KFORIT ate here kur do ta organizojme ditën e fillimit te punimeve per kete projekt.
- *Kekresa per takim me Ministrin e Infrastruktures Lutfi Zharku,
- *Takim me perfaqesuesit e kompanise Alb Architekt (Afrimin), ne lidhje me ecurine e projektit.
- *Miratimi i MoM te mbajtur me Passavanten , konsulencen dhe KWE-ne.
- *Dergimi i te gjitha dokumenteve tek Ramadan Sejdiu per aneksen e STRABAG-ut.
- *Takim me perfaqesuesit e Ministrise se Infrastruktures ne lidhje me mundesine e shtyrjes se projektit te zgjerimit te rruges per shkak te projektit tone te kolektorit, me crast u dakordua qe te pritet deri sa te fillojme ne me projektin.
- *Takim me perfaqesuesin financiar te Passavante (Egzonin), ne lidhje me perpilimin e profatures per terheqjen e mjeteve nga MMPH per Fazen I, ku u konkludua qe Passavante ta beje nje profature por me TVSH brenda dhe pastaj te shiqohet mundesia e pjeses tjeter qe i takon avancit.
- *Takim me KWE-ne ne lidhje me mundesine e fillimit te punimeve dhe diskutimi per kapenderdhsat.
- *Pergaditja e prezantimit per Kanakon ne takimin e Pejes, ku u perpilua prezantimi ne aspektin e shperndarjues dhe zbatimit te pervojave Japoneze ne vendin tone.
- *Takim konsultues dhe raportues me Kryeshefin Ekzekutiv,
- *Takim ne Prishtine ne Keshillin Nderministror ne emer te grupit per Menaxhimin e Ujerave te Zeza,
- *Takim me Agim Thaqin ne MZHE une dhe Limani, ku u diskutua per kost-benefitin e projekteve te KASH, mirpo ne nuk kemi nevojte te dergojme Kost-benefit pasi qe projektet tona nuk kalojne vleren mbi 400 mije euro.

*Telefonate me Ferit Tafallar in ne lidhje me fillimin e punimeve, Ministria ka filluar punimet dhe me Feritin biseduam qe se paku deri sa te vjen deri tek vendosja e skajoreve ne mes te kemi mundsi te fillojme me vendosjen e kolektorit tone.

*Ne sot me kete date e kemi kryer avancin prej 20% te vleres se kontrates, kshtu qe tani mbetet vetem te fillojne punimet.

*Plotesimi i aplikacionit dhe punimi i Job Raportit per JICA derguar tek Arberore Riza.

*Kontakt telefonik me Premtim Islamin ne lidhje me viziten qe Premtimi e ka pas me perfaqesues te Ministrise se Financave ne Bunarin I dhe II per punet qe jane bere me investimin e KfW-se, i njejti u njoftua edhe per pagesen e avancit tek kompania pune kryese Passavnte.

*Kontakt telefonik me me Agim Lajcin udheheqes teknik i projektit ne KWE, i cili u njoftua me pagesen dhe mori persiper fillimin sa me te shpejt te punimeve.

*Kontakt telefonik me Afrim Demirin i cili ishte i njoftuar nga Liman Gashi per pagesen e avancit si dhe nga i njeti kerkova numrin e Argjend Ibrahimit perfaqesues i KWE-se si nenkontraktktor i PASSAVANTE-es.

*DERGIMI DHE NJOFTIMI I TE GJITHEVE PERMES EMAILIT PER PAGESEN E AVANCIT DHE DATEN E FILLIMIT TE PUNIMEVE.

*Takim ne MZHE dorezmi i kerkeses per lehtesimin e taksava doganore per importin e materialit per Fazen I me Adem Ahmetaj

*Kerkesa e permiresuar per subvencionet nga MZHE per konsumatoret minoritar.

*Takim me PASSAVNTE tek zyret e konsulences.

*Takim ne Prishtine me Selatin Novosellen per TVSH-ne dhe Takim me Sekretarin e Ministrise se Zhvillimit Ekonomik per projektete e Gjonaj dhe Lubizhde.

*Takim ne MZHE, per njoftimin per takimin e radhes per Expoforumin "Mënyrat e reja të financimit të projekteve strategjike Kosovë - Shqipëri".

*Takim me Agim Thaqin ne MZHE, ku dhe i regjistruam ne PIP dy projekte Lubizhda e Hasit dhe Gjonaj.

*Takim me Zoge Spahiun ZRRUK per inspektimin e rrjetit te kanalizimit dhe ujerave atmosferike. Ne takim mori pjese vetem Lumniu.

*Takim Javor me Konsulencen dhe punekryesin me crast ne nuk ishim prezent por jane derguar Minutat e Takimit dhe posedojme raportin e permbajtjes se takimit.

*Takim me perfaqesuesit e kompanise ALFA-i, me crast u diskutua per fillimin e punimeve.

*U perpilua Raporti i sherbimit Teknik per muajin Qershor.

*Dalje ne vendin ku do te ekzekutohet projekti i MZHE-se

* Takim ne teren per menyren me te duhur te realizimit te projektit se bashku me KE-ne dhe inxhinieret e kompanise per mundesine e realizmit sa me racional te projektit te MZHE-se.

*Takim me perfaqesuesit e levizjes EC me ndryshe, ku u diskutua ne lidhje me projektin e lagjes se autostrades ne Arbane,

*Dalje ne vendin e punimeve te kolektorit te ujerave te zeza se bashku me KE-ne,

*Perpilimi i Draft projektit per impiantet e fshatrave per takimin me EXPOFORUMIN e organizuar nga Ministria e Diaspores, MzhE dhe Ministria e industrise se Shqiperise

* Takim me Komitetin per Hulumtime dhe Teknologji (Nuk u mbajt takimi)

*Takim me perfaqesuesit e ALFA-I, per dljen ne teren dhe dakordimin perfunimtar

*Takim ne EMERALD ne Prishtine ne EXPOFORUMIN Menytrat e reja te investimeve, organizuar nga M e Diaspores KS, MZHE-Ks dhe M e industrise e Shqiperise.

*Takim me pronaret e shtepive ne kurille per rastin e Enver Viles,

*Takim per performancen e Kryeshefit,

*Vizite Njemujore ne shtetin e Japonise ne lidhje me ngritjen e kapaciteteve ne sektorin e trajtimit te ujerave te zeza.





*Grupi trajnues nga kompania jone pas trajnimit ne kete vit, ka perpiluar Planin e Veprimit me temen „**Ndikimi i sistemeve PTF ne eficiencen e ITUZ-ve në Kosovë**“.

- *Perpilimi i kerkesave per shpallje te konkursit per dy inxhinier ne Departamentin Teknik
- *Dergimi i komenteve tek Klaus Rothe per projektin e masave Shoqeruese.
- *Takim njoftues me kryeshefin ekzekutiv per vazhdimesine e projekteve te cilat jane dule u implementuar.
- *Takim me bashkkontraktorin Hidroterm Blerim kuqin per mundesine e pageses se avancit per Fazen II.
- *Takim ne Prishtine me oden Ekonomike dhe investoret Silloven ne lidhje me mbrojtjen e Ambijentit-Takimi u anulua.
- *Dergimi ne MMPH i fatures se avancit per kompanine AQQUALIA-Faza II me Liman Gashin.
- *Takim ne zyret e konsulences ne lidhje me projektin e ujerave te zeza per Fazen I
- *Vizite ne teren tek kolektori dhe tek lokacioni i ITUZ-se, me crast u konstatua se ne teren nuk ishin duke u zhvilluar punimet.
- *Pergaditja e Dokumentacionit per pagesen e pjeses C te Lot2 per projektin nga MZHE,
- *Takimi i 29 javor per projektin e ujerave te zeza FAZA I me KWE-ne dhe Konsulencen,
- *Pergaditja e dokumentacionit per takim ne Prishtine per Planin e Biznesit Komercial,
- *Dergimi i Mareveshjes se vecante ne MMPH ne lidhje me pagesen e avancit per Fazen II te cilen e keruan Agim Radoniqi dhe Ali Hoxha.
- *Marrja e pelqimit nga Ministria e Infrastruktures per pjesen shtese te rruges nacionale N25.

*Në këtë TM-3 janë bërë leximet e ujëmatësve zonal me qëllim për të verifikuar hargjimet e ujit nëpër zonat e veçanta.

(Për me gjerësisht ekziston raportoni te Kordinatori për Planifikim dhe Zhvillim).

***Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike.**

-  Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
-  Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujesjellesit dhe ndarja e zanave për dedektim.
-  Sensibilizimin e të gjithë konsumatoreve për mos keqperdorim të ujit të pijes përmes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre të shkruara.
-  Ngritjen e vetedijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatoreve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

2.2 Prodhimi i ujit m³ - TM-2 / 2015

Muaji	Prodhimi mujor m ³	Prodhimi ditor- m ³	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,359,000.00	36,912.09	427.2	
Suharekë	493,209.00	5,419.88	62.7	
Dragash	93,010.00	1,033.44	12.0	
Malishevë	321,563.00	3,572.92	41.4	
Total	4,282,590.00	47,061.43	544.7	

TM3- 2015

Muaji	Prodhimi mujor m ³	Prodhimi ditor- m ³	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	4,005,700.00	43,540.22	503.9	
Suharekë	533,015.00	5,793.64	67.1	
Dragash	129,580.00	1,408.48	16.3	
Malishevë	342,464.00	3,722.43	43.1	
Total	5,010,759.00	54,464.77	630.4	

2.3 Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / TM-2, 2015

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	255	163	418
Suharekë	83	11	94
Dragash	09	03	12
Malishevë	75	44	119
Total	422	221	643

TM₃- 2015

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	300	261	561
Suharekë	72	25	97
Dragash	22	11	33
Malishevë	113	50	163
Total	507	347	854

2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim – TM3 - 2015

Për periudhen që po raportojmë në kuader të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në teren kanë vazhduar bllobimet e ujëmatësave nëpër qytetin e Prizren'it, ku kanë arritur këto rezultate: ujëmatësia të bllobuar 436 ujëmatësia, kontrata të nënshkruar 436 kontrata, konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 588 konsumator, ribllobim bllobim për herë të dytë 327, konsumatorët që janë të bllobuar 45, konsumatorët pa ujëmatës 133, konsumatorët që duhet zëvendësuar ujëmatësi 05, rekorde të reja 11, konsumatorët që nuk kanë lidhje uji 05, konsumatorët që duhet regjistruar 16, kërkesa nga konsumatorët për bllobim 14, regjistrim i ri 22, pusët e bllokuar 02.

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	Bllombim-Kontrata	436
2	Ribllombim	327
3	Dera Mbyllur(Heren e dyte)	588
4	Jane te bllombuar	45
5	Rekorde te reja	11
6	Nuk kane lidhje uji	05
7	Zevendesim	05
8	Pa ujemates	133
9	Duhet regjistruar	16
10	Puseta e bllokuar	02
11	Kerkes për bllombim	14
12	Regjistrim i ri	22

Aktivitete kryesore:

* Vazhdimi dhe futja e të dhënave në hartën 7E122009, përgatitja dhe vektorizimi i hartës për teren 7E123009, kontrollimi dhe përfundimi detaj i hartës 7F122103. Refreshimi i hartës 7E123003 nga terreni. Gjetja dhe printimi i objekteve në hartat për dhënjën e pelqimëve në bashkpunim me zyren e faturimit, shefin e inkasanteve.

* Refreshim të hartave:7F12111, 7F123003, kontrollimi i data bases në bashkpunim me faturimin.Pregatitja dhe printimi i formularëve për teren, regjistrimi i rekordeve të reja të sjellura nga terreni.

* Në muajt Korrik - Shtator, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojnë-montojnë 331 ujëmatës, ekzistojnë raporte të veçanta.

* Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Korrik - Shtator, ka bërë gjithësej 166 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 92 defekte, ekzistojnë raporte të veçanta. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 3,393 m.

* Leximi i ujëmatësave zonal gjatë muajve Korrik - Shtator, ujëmatësat në pikat matëse:

Jusuf Gervalla (lexim i ujet), Sheshi i Lidhjes (lexim i ulet), Atmaxh (baypass). Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt për këta muaj.

* Po ashtu gjatë muajve Korrik - Shtator, kemi pasur 11 raste për riparime të ujëmatësave që janë sjellë nga vet konsumatorët.

2.5 Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: TM-2, 2015

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipin e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit. Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Njësia Operative	Profili Φ mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	70	-Ndërrimi i ujëmatësve në NTSH "RIMED" („Farmakos“) -Gjonaj i poshtëm „ Θ 150mm“ : ndërrim
	3/4"	227	
	1"	16	
	5/4"	00	
	6/4"	03	
	Gjithsejt:	316	
Suharekë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	1"	00	
	Gjithsejt:	00	
Dragash	1/2"	13	
	3/4"	02	
	1"	03	
	2"	01	
	Φ 50	01	
	Gjithsejt:	20	
Malishevë	1/2"	05	
	3/4"	26	
	1"	00	
	Gjithsejt:	31	

Totali: 370 riparime të ujëmatësave

Plus:
Leximi i ujëmatësve, 2 x në muaj.
01 Ekspertiza

Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: TM3 - 2015

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	81	
	3/4"	237	
	1"	31	
	5/4"	03	
	6/4"	00	
	Gjithsejt:	352	
Suharekë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	1"	00	
	Gjithsejt:	00	
Dragash	1/2"	11	
	3/4"	31	
	1"	01	
	2"	00	
	Ø 50	00	
	Gjithsejt:	43	
Malishevë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	1"	00	
	Gjithsejt:	00	

395copa

+ 01 ujëmatës $\frac{3}{4}$ Hoqa Vogel

+ 01 ujëmatës 1' per Poslisht

Totali: 397 riparime te ujëmatësave

Plus:

-Leximi i ujëmatësve, 2 x në muaj.

-07 ekspertiza, 04 per KRU "Bifurkacion" Ferizaj

2.6 Analizat fiziko-kimike dhe bakteriologjike

Laboratori "Hidroregjioni Jugor" Prizren Aktivitetet

- * Eliminimi i defektit në injektorin Bunari I;
 - * Ndërrimi i injektorëve në Bunarin I për rezervoarin Kala dhe Rezervoarin e Kurillës (për KFOR-in Gjerman). Pasi që I kemi dërguar të dy injektorët për riparim, edhe pse nuk kemi dakorduar për çmimin e riparimit (në zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv), kemi dakorduar të furnizohemi me injector të rinj (çmimi shumë më i favorshëm se riparimi i injektorëve të vjetër), kemi bërë montimin e tyre për këto rrjeta të furnizimit;
 - * Furnizimi i rregullt me Na-Hipoklorit fshatrat e Hasit, L.e Hasit, K.i Hasit dhe Kushnin;
 - * Ndërrimi i bombolës 1t-she me klor gaz në Mulli;
- Shënim: Edhe pse kemi pasur shumë vështësi për furnizim të rregullt të konsumatorëve me ujë të klorinuar (për shkak të problemeve të lartëcekura) kemi arritur që asnjë analizë e ujit të mos devijojë për nga kualitetit gjejmësisht, të gjitha analizat i përgjigjen standardeve të ujit të pijes.
- * Kontrollimi permanent i burimeve, procesit të klorifikimit dhe prezencën e klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit;
 - * Eliminimi i defektit në injektorin në „Mulliri i Vjetër” në Φ 400;
 - * Pranimi i ngarkesës së klorit dhe ndërrimi i bombolës 1t-she me klor gaz në Mulli.
 - * Është eliminuar defekti në injektorin për klor gaz të Pusi i Atit;
 - * Mbledhje me anëtarët e Bordit për Hulumtime dhe Teknologji. Është dhënë raporti për cilësi të ujit ;
 - * Për shkak të ankesës për kualitet të ujit në fshatin Kabash të Hasit janë marrë hapa të duhura për eliminimin e parametrave që kanë ndikuar në cilësinë e ujit në katë fshat. Kështuqë, është bërë dezinfikimi i rrjetit dhe rezervoarit në tërësi (3 ditë). Janë bërë analizat e duhura, bakteriologjike dhe fiziko-kimike, disa herë, përderisa analizat nuk kanë qenë në nivelin e duhur, gjegjësisht, kur analizat kanë qenë negative. Vlen të përmendet se, përderisa nuk eliminohen shkaktarët që mund të ndikojnë në cilësinë e ujit nuk do të ketë rezultate të kënaqshme (largimi i plahërave përgjatë rrjetit furnizues si dhe përcjellja e dozimit të klorit në mënyrë permanente (klori residual);
 - * Kemi vizituar Ujësjiellësin e Zhur-it për të instaluar dozatorin për dozimin e klorit me Q.Jonuzin, por aparati në fjalë nuk ka funksionuar;
 - * Pasi që dozatori për dozimin e klorit në Lubizhdë të Hasit është jashtë funksionit kemi insistuar që punëtori i ngarkuar për këtë çështje të dozojë klorin me pika përderisa dozatori të riparohet nga ana e Q.Jonuzit.

Analizat Bakteriologjike Korrik - Shtator 2015, TM-3, ISHP-Prizren

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	03	01
	Ujësjiellës	155	00
Suharekë	Burim	00	00
	Ujësjiellës	20	00
Dragash	Burim	01	00
	Ujësjiellës	05	00
Malishevë	Burim	00	00
	Ujësjiellës	17	00
Totali		201	00

Laboratori "Hidroregjioni Jugor" Prizren

2.7 Raport për trajtimin e Ujërave të Zeza

Sa i perket Fazes se Pare që ka të bëjë me ndërtimin e kolektorit kryesor në anën e djathtë të rrjedhjes së lumbardhit dhe rehabilitimin e disa pikave problematike në lagjen Kurilla dhe në zonën Industriale:

Punimet në terren për fazën I kanë filluar më 23.06.2015. Deri më tani kanë përfunduar punimet për pjesën A të kolektorit ku dhe që nga dita e fillimit e deri më tani janë vendosur rreth 1800m gyp, gjithashtu janë instaluar 36 puseta .

Sa i perket monitorimit të punimeve në terren çdo ditë përfaqësuesit e HRJ jemi prezent dhe Konsulenca e projektit, ku dhe mbahen takime javore në lidhje me ecurinë e projektit të cilat dhe i posedojmë. *(Për më gjerësisht raportin Kryetari i Komitetit të Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojmë raportin periodik në të cilin janë përshkruar të gjitha aktivitetet në lidhje me këtë projekt).*

Sa i perket fazës së dytë të projektit të ujërave të Zeza që ka të bëjë me ndërtimin e ITUZ-se, kemi marrë konfirmimin nga KfW për kompaninë AQUALIA&Hidroterm me të cilën kemi nënshkruar kontratën më datë 05.05.2015. momentalisht jemi në fazën përgaditore për fillimin e punimeve. Pas takimeve që kemi pas me kompaninë dhe korespondencave me KfW-në është dakorduar që avanci prej 20% e vlerës së kontratës të paguhet 625,000.00 Euro nga MMPH dhe pjesa e mbetur nga Banka Gjermane KfW. Aqualia&Hidroterm ka për të hapur kompaninë me seli në Kosovë dhe në momentin që do të dorëzohet faktura për pagesën e avancit prej 20% atëherë do të realizohet pagesa.(Për më gjerësisht raportin Kryetari i Komitetit të Projektit Lulzim Paçarizi).*

*Sa i perket pagesave në lidhje me Fazën I përpos pagesës së avancit prej 20% të vlerës së kontratës ende nuk është bërë ndonjë pagesë tjetër, sipas takimeve që kemi pas me kontraktatorin jemi dakorduar që të përgaditet pozicioni i për pagesë në një fakturë të vetme e cila do të përfshijë punimet e realizuara prej fillimit e deri në muajin Tetor. *(Për më gjerësisht raportin Kryetari i Komitetit të Projektit Lulzim Paçarizi dhe i posedojmë raportet javore , mujore dhe raportin periodik në të cilin janë përshkruar të gjitha aktivitetet në lidhje me këtë projekt).* Pagesa e avancit nga kontributi vendor do të realizohet në muajin tetor në si AEP e kemi dorëzuar kërkesën për tërheqjen e mjeteve në MMPH.

Sa i perket fillimit të punimeve janë duke u bërë parapergaditjet mobilizuese dhe kompania kontraktuese ka derguar situacionin e vendosjes së paisjeve për ITUZ, si dhe janë duke dizajnuar projektin detal i cili do të jetë i domosdoshëm për aplikimin në MMPH për dënimin e pelqimit në departamentin e ndërtimit brenda MMPH-se.(Për më gjerësisht raportin Kryetari i Komitetit të Projektit Lulzim Paçarizi).*

Sa i perket pjesës së dytë të fazës së dytë të projektit të ujërave të Zeza që ka të bëjë me Masat Shoqërore si dhe kemi me raportuar me heret janë parakualifikuar 5 kompani. Këto kompani i kanë dorëzuar ofertat teknike dhe financiare dhe jemi në fazën e avluimit të pjesës teknike. Deri në fund të muajit Nentor 2015 besojmë që do të shpallet edhe kompania fituese për këtë projekt.(Për më gjerësisht raportin Kryetari i Komitetit të Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojmë raportin periodik në të cilin janë përshkruar të gjitha aktivitetet në lidhje me këtë projekt).*

2.8 Raport i aktiviteteve të Njësive Punuese

Aktivitetet TM-2, 2015 - Njësia Prizren

Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, përveq në disa raste kur ka pasë ndonjë ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjet të ujësjellësit dhe gjatë punimeve për pastrimin e ujëmatësave.

Prodhimi i ujit: në këtë muaj janë prodhuar 4,005,700.00m³ ujë ose 503.9 l/s dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët përveq në lagjet me sistem pompimi Bazhderhanen, Dardanin dhe pjesën e eperme të Tusuzit.

Humbjet e ujit: humbjet e ujit arrijnë në 58.69% për shkak të rrjetit të vjetër të ujësjellësit, dhe ndërhyrjeve të pa legalizuara.

Operacionet e mirëmbajtjes së ujësjellësit dhe kanalizimit:

Gjatë muajit Gusht furnizimi me ujë ka qenë i rregullt 24 orë në zonat e ulta dhe me reduktime në lagjet Dardania ,Bazhderhane dhe Tusuz

Gjatë TM-3, kanë vazhduar keqperdorimet dhe ujitjet dhe verehet dukshem mungesa e ujit nëpër fshatra dhe si pasojë e ujitjes lagje të shumta kanë mbetur pa uje.

Ka përfunduar projekti për kazermë ku edhe janë ndërprerë plasaritjet e gypit të cilat kanë ndodhur më herët.

Gjatë TM-3, kemi pasur plasaritje të gypit Ø 400 ku është sanuar defekti

Gjatë TM-3, janë marrë disa hapa konkretë lidhur me sanimet kolektive ku në kordinim me komunitetin, Komunën dhe Hidroregjionin Jugor janë ndërruar gypat e furnizimit në disa rrugica si rruga Mihael Grameno, Rruga Perveza, banesat e Solidaritetit.

Rruget të cilat janë përfunduar, gypin e ka furnizuar Komuniteti punët teknike Kompania kurse shtrirjen e rruges me kubza e ka krye Komuna.

Gjatë TM-3, janë shqyrtuar gjithësejt **558** ankesa dhe të gjitha kanë përfunduar me eliminimin e defekteve të ndryshme

Në rrjetin e ujësjellsit janë bërë **371** aktivitete, ndërsa në rrjetin e kanalizimit **1197** raste

Gjithësejt aktivitete në Ujësjellës TM3																				371		
1	Lloji i gypit apo profili	Ø 1 / 2	Ø 3 / 4	Ø 1	Ø 5 / 4	Ø 6 / 4	Ø 2	Ø 5	Ø 6	Ø 8	Ø 1	Ø 1	Ø 2	Ø 2	Ø 3	Ø 4	Ø 6	Ø 0	C i s t e r n a	K o m p r e s o r	R e g u l i m i	
2	Defektet në bazë të profilit të gypit	26	91	63	29	11	37	2	6	5	4	9	10	1	11	2	0	18	22	0		
3	Defektet në rrjetin Sekondar	270																				
4	Defektet në rrjetin primar	37																				
5	Defektet në komplet rrjetin	307																				
6	Bartja e ujit me Cistern	18 m ³																				
7	Pastrimi dhe fryrja me kompresor	22																				

Gjithësejt aktivitete në Kanalizim TM 3		197	
1	Kontroll pusetes	506	copa
2	Pastrimi pusetes	261	copa
3	Kontroll Kanaliz.	8785	metra
4	Pastrimi kanaliz.	5883	metra
5	Ndërrimi pusetes	21	copa
6	Ndërrimi kanaliz.	19	metra
7	Riparimi Rrugës	172	met. Katror

Trajtimi dhe klorifikimi:

Këto veprime bëhen pa ndërprerje dhe analizat e ujit nga Enti Higjienik Regjional janë në bazë të raporteve mujore.

Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit

- Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në Qytet dhe regjion (fshatra dhe sipas nevojës edhe në njësit tjera si Suharekë, Malishevë e Dragash).
- Marrja e mostrave në Qytet, Njësi (si „Hidroregjion Jugor”) dhe në Fshatra të cilat menagjohen nga ana jonë dhe punimi i tyre në laboartorin tonë.
- standardeve të ujit të pijes. Mostrat janë marrun si vijonë:
- Marrja e mostrave **Fiziko-Kimike**
- Marrja e mostrave **Bakteriologjike**

Aktivitetet TM-2, 20105 - Njesia Suharekë

**Furnizimi me ujë TM-3-2015*, ka qenë me reduktime për arsye të rritjes së shpenzimeve dhe keqpërdorimeve të ujit sipas orarit të reduktimeve i cili ka qenë i publikuar në mediat lokale dhe në kompani.

**Analizat e ujit - Gjatë TM-3/2015*, janë realizuar 12 mostra të analizave bakteriologjike dhe 12 mostra i'u kanë përgjigjë standardeve sipas Institutit të Shëndetit Publik.

**Rregullimi i defekteve - në TM-3/2015*, është intervenuar 97 defekte dhe atë 25 në rrjetin sekondar dhe në kyqjet individuale 25 deblokime të kanalizim si dhe janë bërë 50 kyqje të reja në ujësjellës, fshatin Mushtisht dhe Studenqan ku punët e montimit i ka kryer kompania, janë rregulluar 7.0 m² kubza.

**Kyqje në rrjetin e ri të ujësjellësit në fshatin Mushtishtë, vazhdimi i punimeve nga muaji paraprak* - Në bashkëpunim me Komunën janë duke u kryer kyqjet në rrjetin e ri të ujësjellësit. Punët e gërmimit janë duke u realizuar nga një kompani private e cila është duke e rregulluar rrugën ndërsa punët furnizimin dhe montimin e pjesëve për kyqje e konsumatorvë janë duke u bër nga kompania deri me tani janë realizura 18 kyqe.

**Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellist nga Ø63mm PVC në Ø90mm PE me gjatësi L=850m në fshatin Studenqan, vazhdimi i punimeve nga muaji paraprak* - Në bashkëpunim me Komunën është duke u bërë zëvendësimi i gypit ekzistues dhe realizimi i kyqjeve familjare. Punët e gërmimit dhe furnizimi me pjesë të nevojshme për ujësjellës janë duke u bërë nga Komuna ndërsa punët montuese janë duke u bërë nga kompania deri me tani janë përfundura 28 kyqje ekzistuese në rrjetë.

**Vendosja e gypit te ri Ø90mm PE, me gjatësi L=1500m, ne fshatin Sopi* - Në bashkëpunim me Komunën është duke u bërë vendosja e gypit te ri dhe krijimi i 10 daljeve sekodare nga gypi kryesore. Punimet e germimeve dhe furnizimi me material eshte bere nga Komuna e Suharekes ndersa punet montuese jan realizuar nga kompania.

Verejtje : Kjo pjese per momentin ka mundesi te furnizimite me uje te pijes, per arsye se gjendet ne lartesi te madhe nga pika e furnizimit te fshatit.

** Kyqje në rrjetin e ri të ujësjellësit në fshatin Semetishtë* - Në bashkëpunim me Komunën e Suharekës është duke u bërë vendosja e gypit të ri në një pjesë periferike të fshatit, me gjatësi 200 m dhe diametër të gypit Ø 63mm, punët e gërmimit janë duke u realizuar nga kompania jonë K.R.U “ Hidroregjioni Jugor” ndërsa furnizimi me gypë dhe pjesë fazonike janë të financuar nga komuna, deri më tani, janë realizuar 4 lidhje të reja, në këtë pjesë të gypit.

Aktivitetet TM-2, 2015 – Njesia Malishevë

*Furnizimi me ujë gjatë TM-3/2015, ka qenë i mirë dhe pa reduktime.

*Analizat e ujit – Gjatë TM-3/2015, janë realizuar 15 mostra të analizave bakteriologjike dhe 15 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

*Aktivitete lobimi - Kontakte të rregullta me perfaqësuesit e Drejtorisë së Urbanizmit, si dhe me Drejtorin e Financave.

*Takim me perfaqësuesit e kopanis N.N.QENDRIMI, për projektin Rinovimi I Kanalizimeve në fshatrat e K.Malisheve, ku kanë filluar punimet në këtë projekt.

*Takim me perfaqësuesit e kopanis N.N.BELI, për projektin Ndertimi i Galerive ujëmbledhëse në fshatin Senik, ku jemi duke pritur fillimin e punimeve në këtë projekt.

*Takim me perfaqësuesit e kopanis N.N.SH BURIMI, për projektin “Hapja e puseve pizometrike në K.Malishevë, ku janë duke vazhduar punimet në këtë projekt.

*Rregullimi i defekteve - TM-3/2015.

Rrjeti primar 49 defekte, rrjeti sekondar 64 defekte, deblokimi i kanalizimeve 17 ndërhyrje dhe 5.3 km kanal të pastruar, ankesat teknike 16, ankesat komerciale 16, njoftime për shkyqje 217, shkyqje për mos pagesë 3, kyqje ilegale 17, shkyqje të kyqjeve ilegale 19, rikyqje 6, kyqje të reja 55, amvisëri 49, lokale 6, Nr.i bllobave 296, procesverbale të shkyqjeve 19, verifikim të ujëmatësave 622, inkasimi nga kontrolli 10,625.12 €, ujëmatësia të ndërruar 23, ujëmatësia të montuar 18.

Aktivitetet TM-2, 2015 - Njesia Dragash

*Furnizimi me ujë - gjatë TM-3, ka qenë i rregullt në përgjithësi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këti muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftushëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusëve dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh, është pastruar edhe kaugulatori.

*Trajtimi i ujit (sendimentimi,kaugulimi,filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimësi.

*Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto: 5 kyqje në ujësjellës, 1 shkuqje në rrjetin e ujesjellesit, 1 rikyqje në rrjetin e ujesjellesit, 11 pastrim i pusëve të kanalizimit, 155m deblokim dhe pastrim në rrjetin e kanalizimit, 22 raste sanim në rrjetin e ujësjellësit, 2 raste sanim në rrjetin e kanalizimit, 20 ndrrime të ujëmatësave, 13 montime të ujëmatësave të ri, 52 pastrim dhe kontrole të ujëmatësave, 17 angazhime tjera të ekipit teknik.

*Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon kompania duke i përfshir punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratës së përgjithëshme.

*Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimit në Dragash, në fshatin Pllavë,në fshatin Shajne dhe në fshatin Brezne.

*Prodhimi i ujit: në këtë muaj janë prodhuar 129.580.m3 ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

*Humbjet e ujit: humbjet e ujit këtë muaj arrijnë deri në 50.4 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësit.

III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË

3.1 Aktivitetet

- Në fund të TM3 2015 në nivel Rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 42,387 fatura, prej tyre: 36,717 amvisëri , 5,064 biznese dhe 606 institucione. Në fund të TM3 në krahasim me TM2 kemi 469 fatura të lëshuara me tepër.
Ky numër i konsumatorëve është rezultat i regjistrimit të konsumatorëve të rinj , 25 prej tyre nga pëlqimet për kyqje, ndërsa pjesa tjetër si rezultat i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve të rinj në zonën e shërbimit të KRU ‘ Hidroregjioni Jugor’ sha.

TM2-2015

Konsumatorët e Regjistruar	numër	41,918
Konsumatorët Shtëpiak	numër	36,305
Konsumatorët Komercial-Industrial	numër	5,010
Konsumatorët Institucional	numër	603

TM3- 2015

Konsumatorët e Regjistruar	numër	42,387
Konsumatorët Shtëpiak	numër	36,717
Konsumatorët Komercial-Industrial	numër	5,064
Konsumatorët Institucional	numër	606

- Gjatë TM3 2015 janë faturuar **2,106,652 m³** ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: **1,785,293 m³**, biznese: **155,256 m³** dhe institucione **166,103 m³** ujë. Nëse e krahasojm me TM2 kemi një faturim më të madh prej **292,536 m³**. Rritje e sasisë së faturimit në krahasim me TM2 ka ndodh për arsye të rritjes e sasisë së faturuar në m³ të ujit është rritja e konsumit sezonal të ujit si dhe rritja e numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit .

TM2-2015

Uji i Faturuar	m3	1,814,116.00
Konsumatorët Shtëpiak	m3	1,514,474.00
Konsumatorët Komercial-Industrial	m3	126,951.00
Konsumatorët Institucional	m3	172,691.00

TM3- 2015

Uji i Faturuar	m3	2,106,652
Konsumatorët Shtëpiak	m3	1,785,293
Konsumatorët Komercial-Industrial	m3	155,256
Konsumatorët Institucional	m3	166,103

- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç'kyçjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a. Gjatë TM3 2015 në nivel rajonal nga ekipet e kontrollës janë vizitu 1407 konsumatorë, janë regjistru 219 konsumatorë të cilët bazuar në procedurat e mbrendshme janë legalizuar konsumatorët ilegal. Janë inkasuar 20,710.71 euro nga konsumatorët të cilët kanë borxhe mbi 100 euro.

3.2 RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES – TM2 2015

TM2- 2015

Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Kyçje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
Prizren	325	13	4	2013	31,485.94
Suharekë	25	11	11	2716	9,260.00
Malishevë	44	15	6	772	11,417.94
Dragash	9	0	0	17	0.00
KRU "Hidroregjioni Jugor"	403	39	21	5518	52,163.88 €

TM3-2015

Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Kyçje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
Prizren	100	0	0	398	0.00
Suharekë	71	4	8	387	9,865.78
Malishevë	48	3	16	622	10,844.93
Dragash	0	0	0	0	0.00
KRU "Hidroregjioni Jugor"	219	7	24	1407	20,710.71 €

- Gjate TM3 janë pranuar 344 ankesa në total, prej tyre 244 ankesa teknike dhe 100 ankesa komerciale. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar në pajtim me procedurat e mbrendshme te Kompanisë, te ankesat komerciale konsumatorët kanë marr përgjigje me shkrim nga komisioni i cili ka shqyrtuar këto ankesa.

TM2-2015

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	210
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	210
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	89
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	89
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	89
TOTAL		299

TM3- 2015

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	244
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	244
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	100
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	100
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	100
TOTAL		344

3.3 PROBLEMET QË KANE NDIKUAR NE MOSARRITJEN E CAQEVE

- Vonesat e alokimeve ne thesar nga Buxheti i Kosoves, po ndikon ne vonesat e pagesave me kohe nga konsumatorët institucional.
- Gjendja e rënde ekonomike e një numri të konsiderueshëm e konsumatorëve, Shërbimi me Konsumatorë në secilën njësi është duke i evidentuar rastet të cilët janë nën përkuajtje sociale dhe pastaj ti drejtohem i Qeverisë apo Ministrive përkatëse lidhur me pagesën e këtyre obligimeve. Është shqetësues numri i konsumatorëve që viziton zyret e shërbimit me konsumatorë në secilën njësi e të cilët ankohen në pamundësi të pagesës së obligimeve të ujësjellësit.
- Riorganizimin e ekipeve te kontrolles gjate muajit shtator
- Vonesa e implementimit te Ligjit per Faljen e Borxheve

3.4 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Jane pergaditit listat e konsumatoreve te cileve do te ju falet borxhi.
- Eshte pergadit logjistika e nevojshme (ne staf dhe softver) per implementimin e Ligjit per Faljen e Borxheve.
- Rritje në numrin e konsumatorëve në zonën e shërbimit për 469 konsumatorë.
- Janë vizituar 1407 konsumatorë tek të cilët është bërë vizit rutinore për lexim të ujëmatësve, keqpërdorime eventuale të ujit etj.

3.4 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN E ARDHSHEME

- Vazhdimësia e shpërndarja e njoftimeve për mospagesë dhe njoftimeve per falje te borxhit te të gjithë konsumatorët , duke nderruar terrenet dhe dhënia e një afati për pagesë, në rast të mospagesës vazhdimi me shkyqje.
- Njoftime të rregullta në media dhe apel për pagesën e obligimeve në media elektronike dhe të shkruara.
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të borgjeve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borgjeve në menyrë që këta konsumatorë të futen në sistem të pagesave të fakturave.
- Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti për mos pages nuk do të rikyqen pa i paguar së paku 30% të borgjit total .Te këto raste nuk do të bëhet rikyqja pa u bërë një pjesë e pagesës dhe të nënshkruhet kontrata për riprogramim të borxheve.

- Marrja e masave ligjore sipas Zyres Rregullative për shkyqjen e konsumatorve për mos pages. Secili konsumatorë para shkyqjes duhet të njoftohet bazuar në procedurat ligjore nga Zyra Rregullative.
- Rritja e efikasitet të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyqjes.
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borgjeve aty ku kan vështirsi inkasantet .Në secilin muaj do të caktohet një teren dhe kontrolla do të merret me konsumatorët që nuk paguajn borxhet.

3.5 Raport i medieve

KORRIK - 2015

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	02.07.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E FURNIZIMIT PËR SHKAK TË PLASARITJES SË GYPIT
2	02.07.2015	www.rtvbesa.com	PËR SHKAK TË NJË DEFEKTI, NESËR PA UJË MBETET LAGJJA "KURILLA" DHE "NËNË TEREZA"
3	02.07.2015	TV-OPINION	PRONONCIM LIDHUR ME FURNIZIMIN E FSHATRAVE TË HASIT
4	03.07.2015	TV-OPINION	PJESËMARRJE NË EMISIONIN E DREJTËPËRDREJTË TË MËNGJESIT
5	05.07.2015	RTK	PRONONCIM RRETH FURNIZIMIT ME UJË NË FSHATRAT E HASIT
6	06.07.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT PËR SHKAK TË NDËRRIMIT TË GYPIT
7	06.07.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA SUHAREKË: REDUKTIME PËR SHKAK TË RRRITJES ENORME TË KONSUMIT TË UJIT DHE KEQPËRDORIMEVE
8	06.07.2015	www.prizrenpress.com	TRI LAGJE NË PRIZREN, TË MËRKURËN PA UJË
9	06.07.2015	www.rtvbesa.com	TË MËRKURËN DISA LAGJE TË PRIZRENIT DHE SUHAREKËS DO TË KENË REDUKTIME TË UJIT
10	07.07.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	TË MËRKURËN LAGJET DARDANIA,BAZHNDARHANE DHE NJË PJESË E KURILLËS NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
11	07.07.2015	www.tv-opinion.com	NESËR LAGJET DARDANIA,BAZHNDARHANE,KURILLA DHE RRUGA JANINA, 9 ORË PA UJË
12	10.07.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	11 FSHATRA TË PRIZRENIT NESËR NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
13	10.07.2015	www.tv-opinion.com	TË SHTUNËN, PREJ ORËS 10:00 DERI NË ORËN 14:00, DISA PJESË TË PRIZRENIT PA UJË
14	10.07.2015	www.rtvbesa.com	DISA FSHATRA TË HASIT, NESËR DO TË KENË REDUKTIME TË UJIT TË PUJES
15	10.07.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË FSHATRAT E HASIT,
16	13.07.2015	KOHA DITORE	ARTIKULLI: KAMERA E ROJE NË MBROJTJE TË UJIT
17	14.07.2015	KOHA DITORE	ARTIKULLI: SIGURIA E BURIMEVE TË UJIT

18	14.07.2015	RTK	PRONONCIM: SIGURIA E BURIMEVE
19	14.07.2015	www.rtklive.com	ARTIKULLI: BURIMET E UJIT TË PIJES NË PRIZREN TË SIGURTA
20	14.07.2015	ZËRI	ARTIKULLI: MASAT E SIGURISË SË BURIMEVE
21	15.07.2015	RTK	PAGESAT PËRMES POSTËS- EMISION I LAJMEVE
